



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 08.08.2025

Numër Protokoli: 5311/2025

A.nr.1066/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1066/2025, të datës 04.06.2025, të parashtruar nga ankuesi D.A, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1066/2025, e datës 04.06.2025, e parashtruar nga ankuesja D.A.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, D.A (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), me datë 29.05.2025, përmes postës, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 04.06.2025 dhe është regjistruar nën shenjen A.nr.1066/2025, kundër Njoftimit të datës 28.03.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për refuzimin e aplikacionit lidhur me konkursin me Nr. Reference RN00016679 për pozitën Zyrtar Administrativ, i shpallur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 12.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje MMPHI), ndërsa kjo e fundit me datë 13.06.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1066/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se MMPHI, më datë 11.02.2025 ka shpallur Konkursin me Nr. Reference: RN00016679, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën e punës “Zyrtar Administrativ”, numri i kërkuar tre (3) pozita, klasa e pozitës profesional 3, me afati aplikimi nga data 12.02.2025 deri më datë 13.03.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar 183 kandidatë, mesin e tyre edhe ankuesja, ndërsa sipas njoftimit të datës 28.03.2025, fazën e verifikimit paraprak e kanë kaluar 69 kandidatë, ndërsa sipas Njoftimit të datës 28.03.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të MMPHI-së i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se në aplikacion i mungon diploma e shkollës së mesme si kriter i konkursit.

Pas përfundimit të procedurës, Divizioni i Burimeve Njerëzore në MMPHI, më datë 29.04.2025, ka publikuar njoftimin për kandidatin fitues për këtë pozitë, me tre kandidat fitues: G.D me 77.8 pikë, F.B me 77.6 pikë dhe A.P me 72.6 pikë, ndërsa sipas formularit të renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesja ka marr 70 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar përmes postës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se refuzimi i aplikacionit është bërë në mënyrë të padrejte, ngase kam bashkangjitur diplomën e Fakultetit Juridik, ndërsa njësia përkatës ka gjetur si pretekst që nuk e kam diplomën e shkollës së mesme; Aplikacioni im ka qenë i kompletuar. Njëri nga anëtarët e komisionit të pranimit A.D, ka relacion familjar me njëri nga kandidatet fitues G.D, dhe konsideroj që këtu kemi të bëjmë me shkelje ligjore. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet konkursi.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati D.R, si kandidat aplikues në procedurën e rekrutimit me Nr. Reference: RN00016679, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën e punës “Zyrtar Administrativ”, kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.940/2025, të datës 04.08.2025, ka anuluar në tersi procedurën e pranimit sipas konkursit Nr. Reference: RN00016679, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën e punës “Zyrtar Administrativ”.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1066/2025, të datës 04.06.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.940/2025, të datës 04.08.2025, rrjedhimisht ka anuluar procedurën e pranimit sipas konkursit Nr. Reference: RN00016679, atëherë mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”. Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.1066/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1066/2025, të datës 04.06.2025.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1066/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit D.A;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.